Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 24 janar 2014

Lënda nr. 47/08

Fillim GUGA

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 24 janar 2014, me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek Nowicki, kryesues
Znj. Christine Chinkin
Znj. Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 3 nëntor 2008 dhe është regjistruar më 13 nëntor 2008. Më 19 mars 2009, ankuesi dorëzoi informata shtesë. Ankuesi është përfaqësuar para Panelit nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Më 8 prill 2009, Paneli kërkoi informata nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme).

3. Më 27 korrik 2009, Paneli i dërgoi një kërkesë shtesë Dhomës së Posaçme. Më 30 korrik 2009, Dhoma e Posaçme dha përgjigjen e vet.

4. Më 17 shtator 2009, Paneli kërkoi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), në cilësinë e tij si përfaqësues i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), qasje në dokumentet e AKM-së relevante për ankesën.

5. Më 25 nëntor 2009, Paneli përsëriti kërkesën e vet për PSSP-në, për të pasur qasje në dosjet e AKM-së. Më 4 dhjetor 2009, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

6. Më 13 janar 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi. Më 24 janar 2010, ankuesi ofroi një përgjigje në ndërkohë dhe më 5 shkurt 2010, ai ofroi përgjigjen e tij të plotë.

7. Më 29 prill 2010, Paneli e njoftoi për ankesën PSSP-në lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës. Më 26 maj 2010, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

8. Më 9 qershor 2010, komentet e UNMIK-ut iu përcollën ankuesit për përgjigjen e tij. Ankuesi dha përgjigjen e tij më 19 korrik 2010.

9. Më 9 qershor 2011, Paneli e shpalli ankesën pjesërisht të pranueshme. Më 14 qershor 2011, Paneli e njoftoi PSSP-në për vendimin mbi pranueshmërinë, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

10. Më 16 gusht 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

11. Përmes letrave të datës 18 gusht 2011, Paneli kërkoi nga Dhoma e Posaçme dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), kjo e fundit në cilësinë e trashëguesit në interes të AKM-së, t'i ofrojë kopjet e dosjeve të plota lidhur me ankesën. Asnjë përgjigje nuk u pranua në këtë kohë.

12. Më 21 shtator 2011, Paneli ia përcolli ankuesit komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës, duke e ftuar atë që të japë komente shtesë, nëse dëshironte ta bënte këtë. Ankuesi dha përgjigjen e tij më 12 tetor 2011.

13. Më 18 nëntor 2011, Paneli pranoi nga Dhoma e Posaçme kopjet e dosjes së saj lidhur me ankesën.

14. Më 29 mars 2012, Paneli ia përsëriti kërkesën e vet AKP-së për informata dhe kopje nga dosja e saj. Përgjigjja e AKP-së, së bashku me disa dokumente nga dosja e AKM-së, është pranuar më 4 maj 2012.

15. Më 24 korrik 2012, Paneli kërkoi nga PSSP-ja të ofrojë informata shtesë në dritë të përgjigjes së ankuesit. Më 6 gusht 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

16. Ndërmarrja Shoqërore (NSH) "KNI Dukagjini OTHPB-BP IMN Tjegullorja" (IMN), e punësoi fillimisht ankuesin si punëtor jo të rregullt më 16 prill 1979, punë të cilën e kreu deri më 31 gusht 1979. IMN e riangazhoi ankuesin si punëtor me kontratë të përhershme më 20 qershor 1980. Ai punoi për IMN-në përafërsisht 20 vjet. Ditari i tij i shënimeve në punë e paraqet 23 marsin e vitit 1999 si ditën e fundit të punësimit të tij në IMN. Megjithatë, sipas vendimit të IMN-së nr. 185, të 24 gushtit të vitit 2000, për ndërprerje të punësimit të tij (shih më poshtë, § 18), dita e tij e fundit në punë ishte 17 qershori i vitit 1999.

17. Më 1 korrik 1999 apo përafërsisht rreth kësaj date, babai i ankuesit u zhduk. Së bashku me anëtarët e familjes së tij, ankuesi pastaj u largua për në Mal të Zi, pasi që frikësohej për sigurinë e tij. Më vonë, shtëpia e ankuesit ishte djegur dhe babai i tij ishte gjetur i qëlluar për vdekje.

18. Me vendimin e vet nr. 185 të 24 gushtit të vitit 2000, IMN ia ndërpreu marrëdhënien e punës ankuesit për shkak të mosparaqitjes në punë për një periudhë të gjatë pa arsyetim. Me vendim iu ndërpre marrëdhënia e punës 27 të punësuarve të IMN-së, duke përfshirë ankuesin. Përderisa disa nga të punësuarit e prekur kishin ofruar arsyetime për mungesën e tyre nga puna (të cilat ishin refuzuar për arsye të ndryshme), ankuesi ishte në mesin e një grupi punëtorësh, të cilët supozohej të jenë jashtë vendit dhe kështu nuk mund të kontaktohej nga IMN në lidhje me procedurat e ndërprerjes të marrëdhënies së punës. Në vendim gjithashtu thuhej: "Duke marrë parasysh rrethanat që mbretëruan në Kosovë, IMN nuk organizoi ndonjë seancë shqyrtimi disiplinor deri një vit pas lufte, por meqë të punësuarit e lartpërmendur nuk u lajmëruan fare në punë, [ata] në parim nuk janë deklaruar se dëshirojnë të vazhdojnë punën, dhe meqë ndërmarrja duhet të vazhdojë funksionimin e rregullt, ata në këtë mënyrë duhet të zëvendësohen me punëtorë të rinj." Vendimi ishte publikuar në tabelën e shpalljeve në fabrikë.

19. Me kthimin e ankuesit në Kosovë në vitin 2001, ai vizitoi IMN-në dhe kërkoi që atij t'i lejohet ta rifillojë punën. Kjo kërkesë ishte refuzuar. Ankuesi zyrtarisht kërkoi me shkrim të kthehet në punë më 8 prill 2002 dhe përsëri më 12 mars 2003. Të dyja kërkesat ishin refuzuar.

20. Pas kësaj, ankuesi paraqiti një padi në Gjykatën Komunale të Gjakovës, duke kërkuar rikthim në pozitën e tij të mëparshme në IMN. Më 16 shkurt 2004, Gjykata Komunale e refuzoi padinë e tij, duke konsideruar që procedura e cila ka çuar te ndërprerja e marrëdhënies së punës të ankuesit ishte në pajtim me ligjin. Sipas gjykatës, ankuesi kishte munguar nga puna prej 17 qershorit të vitit 1999 deri më 24 gusht të vitit 2000 dhe nuk e kishte arsyetuar mungesën e tij. Prandaj, një masë disiplinore, ndërprerja e marrëdhënies së punës në kompani atij ishte e imponuar në pajtim me nenin 105 të "Ligjit të Kosovës mbi Marrëdhënien e Punës". Ankuesi paraqiti ankesë ndaj këtij vendimi, por më 28 qershor 2006 Gjykata e Qarkut e Pejës refuzoi ankesën e tij, duke u pajtuar me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe vërtetoi vendimin e gjykatës më të ulët. Ankuesi pastaj u ankua në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 11 tetor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi ankesën e tij dhe e la në fuqi vendimin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata Supreme konsideron se sipas ligjit në fuqi në atë kohë, procedura zyrtare të ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk kërkoheshin për mungesa të gjata të paautorizuara nga puna.

21. Në ndërkohë, IMN ishte privatizuar më 31 korrik 2006. Më 10 prill 2007 AKM-ja e publikoi listën e përkohshme të punëtorëve të IMN-së, të kualifikuar për të marrë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Ankuesi nuk ishte përfshirë në atë listë.

22. Më 19 prill 2007, ankuesi i paraqiti një ankesë AKM-së, duke argumentuar se ai është dashur të përfshihej në listën e përkohshme, duke u bazuar në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, të datës 9 maj 2003, mbi Transformimin e së Drejtës për Shfrytëzimin e Pronës së Paluajtshme në Pronësi Shoqërore (më tutje Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13), në të cilën futen në listë kërkesat për përfshirje në listë. Sipas kësaj dispozite:

> "...punëtori konsiderohet si i kualifikuar nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në

listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vjet. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6 [të Rregullores]"

23. Në ankesën e tij para AKM-së, ankuesi deklaroi se atij i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës në IMN për shkak të diskriminimit. Ai deklaroi se në vitin 1999 kishte frikë të qëndrojë në Gjakovë. Ai theksoi se shtëpia e tij ishte djegur dhe pasi u kthye në Kosovë, në vitin 2001 shtëpia e tij ishte rindërtuar nga një OJQ. Ankuesi gjithashtu deklaroi: "Isha refugjat në Mal të Zi dhe qëndrova në Kotorr, prej ku unë nuk mund të lajmërohesha në punë, pas së cilës punëdhënësi më kishte dëbuar nga puna." Ai deklaroi se ai u paraqit në punë me kthimin e tij, por IMN refuzoi ta rikthejë atë në pozitën e mëparshme. Ai në mënyrë specifike deklaroi: "Unë kam provuar t'i realizojë të drejtat e mia përmes procedurës gjyqësore por pa ndonjë sukses, meqë ata thanë se unë isha lajmëruar në punë tepër vonë. Ndihem i diskriminuar meqë i takoj komunitetit [e]gjiptian[1]. Rasti im është në zhvillim e sipër në Gjykatën Supreme të Kosovës". Ankuesi ia bashkëngjiti ankesës një kopje të ditarit të tij të shënimeve në punë, një kopje të vendimit nr. 185 të 24 gushtit 2000, dokumentet e lëshuara nga Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, që dëshmojnë statusin e tij si i kthyer nga Mali i Zi, dhe kopjet e vendimeve të lëshuara deri më tani nga Gjykata Komunale e Gjakovës dhe Gjykata e Qarkut e Pejës në lidhje me këtë rast.

24. Dosja e Dhomës së Posaçme mbi privatizimin e "IMN-së" përmban një dokument të titulluar "Shënime observuese", që AKM-ja ia dorëzoi Dhomës së Posaçme në korrik të vitit 2007, për sa i përket ankesës së dorëzuar nga ankuesi kundër listës së përkohshme të AKM-së. Në rubrikën "Përgjigjja e AKM-së" në dokument thuhet "AKM vëren se sipas DSH [ditarit të tij të shënimeve në punë] marrëdhënia e punës paditësit i ishte ndërprerë më 23.03.1999 dhe DSH ishte mbyllur me atë datë. Pas lufte, ankuesi nuk u kthye në pozitën e tij të mëparshme, prandaj kontrata e tij e marrëdhënies së punës në NSH ishte ndërprerë prej datës 24.08.2000. Nuk është dhënë asnjë deklaratë, në të cilën ankuesi e përcakton padinë e tij në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores apo nga e cila AKM-ja mund të konsiderojë se ankuesi ishe i diskriminuar. AKM-ja konsideron se pretendimi i ankuesit nuk përputhet me kërkesat e përshkruara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13."

25. Më 25 shtator 2007, AKM-ja i dha përgjigjen e vet ankuesit, që kërkesa e tij për t'u përfshirë në listë duhet hedhur poshtë. Në letër thuhet se "duke u bazuar në dokumentacionin që ju ia keni bashkëngjitur ankesës, është provuar se ju keni punuar dhe kryer detyrat tuaja deri më 23.03.1999. Kjo është vërtetuar përmes kopjes së ditarit tuaj të punës nr. 28361 dhe përmes vendimit nr. 185, të datës 24.08.2000. Sipas dëshmisë së menaxhmentit, ju nuk jeni paraqitur në punë prej datës 17.06.1999". Në letër më tutje thuhet se ankuesi nuk ofroi ndonjë dëshmi se ai kishte ndërmarrë "ndonjë veprim ligjor kundër vendimit nr. 185" dhe se për atë arsye, emri i tij nuk ishe përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar.

26. Më 2 nëntor 2007, AKM-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtën që të marrin një pjesë nga të ardhurat e IMN-së. Ankuesi nuk ishte në listë. Tetë ankesa, duke përfshirë një nga ankuesi, ishin paraqitur në Dhomën e Posaçme kundër kësaj liste. Më 22 janar 2008, Dhoma e Posaçme e shpalli vendimin e vet SCEL-07-002, në të cilin konstatohet se të gjitha ankesat, duke përfshirë atë të ankuesit, ishin të bazuara. Sipas Dhomës së Posaçme, lista nuk ishte publikuar me një vendim të Bordit të Drejtorëve të

[1] "Egjiptian"në kontekst të këtij rasti u referohet pjesëtarëve të komunitetit egjiptian në Kosovë.

AKM-së, siç kërkohet me nenin 64.5 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2006/17, prandaj ishte e paligjshme.

27. Më 26 mars 2008, AKM-ja publikoi listën tjetër të punëtorëve me të drejtën që të marrin një pjesë nga të ardhurat e IMN-së. Ankuesi nuk ishte në listën e publikuar.

28. Më 11 prill 2008, ankuesi përsëri paraqiti një ankesë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit përfundimtar të Bordit të Drejtorëve të AKM-së. Si në parashtresat e mëparshme për AKM-në, ankuesi pohonte se ai kishte punuar për ndërmarrjen deri në fillimin e bombardimit të NATO-s dhe se, pas tërheqjes së forcave jugosllave, ai u largua nga Kosova për shkaqe sigurie. Ai gjithashtu deklaroi se ishe pjesëtar i minoritetit egjiptian. Përsëri, ai dorëzoi dokumentet që dëshmonin statusin e tij si refugjat në Mal të Zi. Ai deklaroi se pas një kohe u kthye në Kosovë, por udhëheqja e ndërmarrjes nuk ia lejoi atij ta rifillojë punën. Ankuesi gjithashtu deklaroi se serbët etnikë, të cilët nuk u paraqitën në punë pas 10 qershorit të vitit 1999, për arsye sigurie ishin akoma të përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar. Ai u ankua se ishte i diskriminuar krahasuar me kolegët e tij të etnitetit serb dhe kërkoi nga Dhoma e Posaçme të anulojë vendimin e AKM-së, që e përjashtonte atë nga lista përfundimtare e punëtorëve të kualifikuar.

29. Më 29 prill 2008, AKM-ja ia ofroi Dhomës së Posaçme përgjigjen e vet ndaj ankesës së ankuesit. Në atë përgjigje AKM-ja thotë se marrëdhënia e punës ankuesit i ishte ndërprerë më "24.08.2000, që nënkupton kohë të gjatë para privatizimit" dhe se, sipas AKM-së, nuk kishte asnjë indikacion se ankuesi e kishte kundërshtuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës atij apo se kishte provuar të kthehet në pozitën e tij të mëparshme. AKM-ja gjithashtu theksoi se nuk kishte asnjë dëshmi se ankuesi kishte përjetuar diskriminim në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të 9 majit të vitit 2003.

30. Në përgjigjen e tij për AKM-në, të datës 12 maj 2008, ankuesi e identifikoi veten si një refugjat, i cili iku në Mal të Zi për të ikur nga persekutimi i disa grupeve në Kosovë. Në veçanti, ai deklaroi se babai i tij, i cili mbeti në Kosovë, ishte vrarë nga persona të panjohur dhe se kjo kishte mundur t'i ndodhte atij nëse nuk do të ishte larguar nga Kosova. Ankuesi gjithashtu deklaroi se ai nuk ishte ftuar për procedura disiplinore dhe se, kur ai u kthye nga Mali i Zi dhe shkoi në ndërmarrje, ata nuk i lejuan atij të kthehet në pozitën e mëparshme. Ai pohoi se ai ishte refuzuar, sepse ishte pjesëtar i minoritetit egjiptian. Ankuesi nuk tregoi se ai kishte paraqitur një padi në gjykatat e rregullta për t'u kthyer në pozitën e mëparshme në punë.

31. Më 4 qershor 2008, Dhoma e Posaçme i lëshoi një urdhër AKM-së që t'i ofrojë vendimin e Bordit të saj të Drejtorëve, "përkitazi me përpilimin e listës së punëtorëve të kualifikuar, të cilët kanë të drejtën të marrin 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH IMN në Gjakovë. Vendimi i përmendur, në pajtim me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, duhet të përmbajë një arsyetim të argumentuar për përfshirjen apo mospërfshirjen e punëtorëve të regjistruar në listë dhe pranimin e kundërshtimeve të tjera ndaj listës".

32. Më 5 qershor 2008, AKM-ja i ofroi një përgjigje Dhomës së Posaçme: "Vendimi i bashkëngjitur i ishte paraqitur Bordit të AKM-së më 26 mars 2008 dhe ishte miratuar". Bashkëngjitur me përgjigjen është një dokument i datës 25 janar 2008, dy ditë pas vendimit për anulimin e listës së parë (shih § 26), në të cilin thuhet në titull "PIKA E RENDIT TË DITËS 5.F.1.B. – Shpërndarja e 20% punëtorëve – NSH "IMN" Gjakovë". Në dokument thuhet se 34 ankesa ishin pranuar kundër listës së përkohshme, duke

përfshirë 30 nga punëtorët shqiptarë dhe 4 nga punëtorët serbë. Katër ankesa (3 serbë dhe 1 shqiptar) janë pranuar për t'u përfshirë në listën përfundimtare. Në dokument nuk është ofruar asnjë emër i ankuesve, në të cilin gjithashtu thuhet: "dokumentet vijuese janë në dispozicion për kontrollim nga ana e Dhomës së Posaçme: lista me emra të listës së përkohshme dhe shqyrtimi i zyrës rajonale, kopja e listës së përkohshme, analiza e detajuar e ankesave në lidhje me listën e përkohshme, drafti i listës përfundimtare". Nuk ka asnjë indikator në dosjen e Dhomës së Posaçme se këto dokumente ishin kërkuar apo kontrolluar nga Dhoma e Posaçme. As që ka ndonjë indikacion të diskutimit dhe vendimmarrjes së Bordit të AKM-së në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës.

33. Në një parashtresë tjetër për Dhomën e Posaçme, të datës 10 qershor 2008, AKM-ja theksoi se shumë nga punëtorët e IMN-së ishin me etni joshqiptare, që përfshin pjesëtarët e komunitetit rom/ashkali/egjiptian. Më tej, thuhet se "si dëshmi se nuk kishte tensione etnike pas qershorit të vitit 1999, një numër i joshqiptarëve u kthye në punë dhe gjithashtu janë bërë publikë në listën me 227 emra". Prandaj ajo sjell prova se megjithëse ankuesi mund të ketë ikur në Mal të Zi për një kohë, duket se nuk kishte baza të arsyeshme për të provuar diskriminimin ["bazuar në faktet që dihen deri më tani"]. AKM-ja gjithashtu deklaroi se vendimi i komisionit disiplinor, i datës 24 gusht 2000, me të cilin u ndërpritet marrëdhënia e punës 27 personave, duke përfshirë ankuesin dhe personat e tjerë, disa të etnitetit shqiptar, për shkak të mungesës së tyre në punë, duket të jetë bazuar në fakte dhe ishte jodiskriminues. Sipas AKM-së, ky fakt ishte kontestuar vetëm nga ankuesi dhe një ish-punëtor në kohën e publikimit të listës së përkohshme.

34. Më 17 qershor 2008, Dhoma e Posaçme nxori vendimin e vet SCEL-08-001, me të cilin refuzohet si e pabazë ankesa e ankuesit dhe shpall se ankuesi nuk ishte kualifikuar të jetë në listën për kompensim. Në vendim, në pjesët relevante, thuhet:

> Dhoma e [Posaçme] pajtohet me standardet ligjore të parashikuara në Ligjin Kundër Diskriminimit [Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 2004/3, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32, të 20 gushtit të vitit 2004]. Parimi i vendosur në nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit është i ndryshëm nga kërkesat për dëshmi të dokumentuar siç parashihet me nenin 10.6 (b) të Rregullores së [UNMIK-ut] 2003/13.
>
> Ankuesit, të cilët pohojnë për diskriminim, duhet të paraqesin fakte nga të cilat mund të provohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Përveç kësaj, sapo ankuesi të paraqesë një rast *prima facie* të diskriminimit direkt apo indirekt, i padituri obligohet të përgënjeshtrojë diskriminimin.
>
> Të gjithë ankuesit … dështuan të paraqesin fakte, nga të cilat mund të provohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt. …
> …
>
> [Ankuesi] punoi për NSH [IMN] prej vitit 1979 deri në qershor të vitit 1999. Ai konfirmoi se pas qershorit të vitit 1999 qëndroi në Mal të Zi për një kohë të gjatë, për arsye sigurie dhe pas kthimit të tij në Kosovë ai provoi të punësohej, por refuzohej në baza diskriminimi.
>
> Pala e paditur kundërshtoi ankesën e ankuesit, duke arsyetuar se marrëdhënia e punës ankuesit i ishte [ndërprerë me] vendimin nr. 185/00, të datës 24.08.2000. Ai nuk ndërmori asnjë veprim ligjor kundër këtij vendimi për t'u kthyer në pozitën e mëparshme për të punuar.

…

Dhoma e Posaçme i ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë dhe pajtohet me analizën e palës së paditur [AKM]. Kështu, Dhoma e Posaçme e refuzon kërkesën e ankuesit për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar.

35. Më 21 qershor 2008, ankuesi paraqiti një ankesë kundër këtij vendimi, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4, të 5 shkurtit të vitit 2008 që amendamenton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e cila përfshiu mundësinë për t'i ankimuar vendimet e Dhomës së Posaçme te një panel tjetër në Dhomën e Posaçme. Më 10 shtator 2008, Dhoma e Posaçme nxori një vendim të dytë, ku refuzohet ankesa e ankuesit. Ajo gjeti se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 ishte amendamentuar më vonë me rregulloret që shtynin hyrjen e saj në fuqi deri më 31 tetor 2008. Prandaj, nuk ishte e mundshme kurrfarë ankese kundër vendimit të 17 qershorit të vitit 2008.

III. ANKESA

36. Duke pasur në konsideratë shpalljen e ankesës të pranueshme, ankuesi ankohet se ai ishte përjashtuar padrejtësisht nga lista e punëtorëve gjatë privatizimit të IMN-së. Ai pohon se gjatë procedurave të AKM-së dhe Dhomës së Posaçme, ai ishte diskriminuar për shkak të etnisë së tij egjiptiane.

37. Ankuesi ankohet se, në pajtim me dispozitat relevante të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe Ligjin Kundër Diskriminimit, ai paraqiti një rast *prima facie* të diskriminimit para Dhomës së Posaçme, e cila, megjithatë, dështoi të adresojë si duhet ankesën e tij në këtë drejtim. Ai gjithashtu ankohet se Dhoma e Posaçme i trajtoi ndryshe ankesat për diskriminim të paraqitura nga serbët etnikë, në rrethana të ngjashme faktike me ato si të tij. Ai deklaron se atij i ishte pamundësuar të vazhdojë punën në ndërmarrje për shkak të origjinës së tij egjiptiane, e cila si pasojë e eliminoi atë *de facto* nga procesi i privatizimit. Për më tepër, ankuesi në esencë pohon se Dhoma e Posaçme nuk mori parasysh diskriminimin indirekt ndaj personave që u takonin minoriteteve etnike në kuadër të procesit të privatizimit.

38. Ankuesi në fund deklaron se, për shkak të kësaj situate, të drejtat e tij në pronë gjithashtu ishin shkelur.

39. Ankuesi, në esencë thirret në shkelje të nenit 14 (ndalim i diskriminimit), shpallur në lidhje me nenin 6 (e drejta për gjykim të drejtë) e KEDNJ-së, nenin 1 (e drejta në shfrytëzim të qetë të pronave) i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 (ndalim i përgjithshëm i diskriminimit) i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 14 në lidhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së

1. Parashtresat e palëve

40. Ankuesi ankohet se ai ishte diskriminuar në procedurat para AKM-së dhe Dhomës së Posaçme në dy baza.

41. E para, ankuesi deklaroi se ai kishte paraqitur faktet për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit para Dhomës së Posaçme, siç kërkohet me ligj. Ai gjithashtu dorëzoi dëshmi relevante për këtë qëllim, duke përfshirë një certifikatë që dëshmon statusin e tij si refugjat në Mal të Zi. Megjithatë, Dhoma e Posaçme deklaroi në vendimin e vet se, ankuesi kishte dështuar të paraqesë fakte nga të cilat mund të konsiderohet se ai kishte qenë viktimë e diskriminimit direkt apo indirekt. Ankuesi argumenton se në rastin e tij Dhoma e Posaçme kishte dështuar t'u përmbahet dispozitave të Ligjit Kundër Diskriminimit për sa i përket peshës së dëshmisë dhe, veç kësaj, ajo dështoi të adresojë ankesën e tij se ai do të kualifikohej për t'u përfshirë në listën e punëtorëve kualifikuar, po të mos ishte viktimë e diskriminimit në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13. Ankuesi në mënyrë specifike deklaron se në rastet e tjera të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që përfshinin punëtorët në situata të njëjta faktike si e tij, Dhoma e Posaçme u kishte njohur të drejtën në të ardhurat e privatizimit ish-punëtorëve që i takonin minoritetit etnik serb, për shkak të faktit se ata e kishin lëshuar Kosovën në vitin 1999 për shkak të shqetësimeve në lidhje me sigurinë. Për sa i përket gjetjes së Dhomës së Posaçme se ankuesi "nuk kishte inicuar asnjë veprim ligjor" kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës, ankuesi deklaron se ky fakt nuk është relevant dhe se në fakt, në rastet e tjera të privatizimit, siç është përmendur më lart, AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme kishin njohur të drejtat serbëve etnikë për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit, megjithëse personat e tillë nuk e kontestuan ndërprerjen e marrëdhënies së tyre të punës përmes procedurave ligjore, duke pasur në mendje situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë pas konfliktit. Ankuesi pohon se Dhoma e Posaçme ka konsideruar se "pagesa e pjesës prej 20% nuk është domosdoshmërisht e lidhur me vazhdimin e punës pas përfundimit të luftës në Kosovë".

42. Ankuesi argumenton se në vendimin në lidhje me rastin e tij, Dhoma e Posaçme dështoi të qartësojë se si kjo situatë ndryshon nga ajo e serbëve dhe pjesëtarëve të minoriteteve të tjera, marrëdhënia e punës e të cilëve ishte ndërprerë në rrethana të njëjta si të tij dhe e drejta e të cilëve në një pjesë të të ardhurave të privatizimit megjithatë ishte njohur. Për sa i përket privatizimit të IMN-së, ankuesi i paraqet Panelit emrat e katër ish-punëtorëve të etnitetit serb, të cilët, sipas tij, ishin në situatë të njëjtë si ai dhe nuk kanë shfrytëzuar procedurat gjyqësore por të cilët, megjithatë, ishin përfshirë nga AKM-ja në listë. Në këtë drejtim, ai pohon se kjo situatë është trajtuar ndryshëm për shkak të statusit të tij si pjesëtar i minoritetit etnik egjiptian.

43. E dyta, ai pohon se kur ishte refuzuar ankesa e tij për t'u përfshirë në listën e punëtorëve me këtë të drejtë, Dhoma e Posaçme dështoi që të marrë parasysh situatën e tij si pjesëtar i minoritetit etnik egjiptian, që e kishte lëshuar Kosovën në qershor të vitit 1999, duke u frikësuar për sigurinë e tij. Ankuesi deklaron se, po të mos diskriminohej për shkak të etnisë së tij, ai do të ishte regjistruar në ndërmarrje dhe kështu do ta gëzonte këtë të drejtë për një pjesë të të ardhurave.

44. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja deklaron se, për sa i përket shkeljes së nenit 6 të KEDNJ-së, ankuesi "gjatë gjithë kohës kishte qasje dhe i shfrytëzoi mjetet juridike që atij iu ofruan në fazat e ndryshme të ankimimit të tij", për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit. Ai ia dorëzoi ankesën e tij së pari AKM-së dhe pastaj Dhomës së Posaçme dhe kurrë nuk i është mohuar qasja në këto mjete. Veç kësaj, institucionet që u morën me ankesat e tij "gjithmonë dhanë një përgjigje të shpejtë".

45. Për sa u përket pretendimeve të ankuesit sipas nenit 14, PSSP-ja argumenton se kjo dispozitë e konventës nuk vlen në këtë rast. Sipas PSSP-së, "vetëm ato çështje të barazisë që janë të lidhura me dispozita esenciale të Konventës apo njërit nga protokollet e saj

mund të adresohen në kontekst të nenit 14. Për shkak të natyrës së tij dytësore, nuk mund të mbështetemi në mënyrë specifike në nenin 14 te çështjet e lidhura me punësimin. Për sa i përket aplikimit të tij në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, meqë nuk ka pasur shkelje të nenit 6 në çështjen në fjalë, neni 14 nuk është i aplikueshëm prandaj ankuesi nuk mund të thirret në të".

46. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, PSSP-ja deklaron se kjo dispozitë e KEDNJ-së përmban një ndalesë të përgjithshme të diskriminimit. Sipas PSSP-së, në ankesën e tij sipas Protokollit nr. 12, ankuesi pohon për "diskriminim që rrjedh nga publikimi i listës përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar nga ana e AKM-së dhe diskriminim që rrjedh nga vendimi i dhënë nga DHP dhe gjykatat e tjera civile". PSSP-ja deklaron se të gjitha autoritetet gjyqësore të përfshira në çështje kanë ardhur në përfundimin se nuk kishte diskriminim; prandaj, "dhe veç rasteve kur vlerësimi për dëshminë në lidhje diskriminimin e pretenduar nga autoritetet e tilla është haptazi i pasaktë, procesi juridik duhet konsideruar si i drejtë dhe korrekt".

47. PSSP-ja përfundon se nuk kishte shkelje të dispozitave të përmendura nga ankuesi.

2. Vlerësimi i Panelit

a) Dorëzimi i dosjeve relevante

48. Paneli thekson se UNMIK-u nuk ia paraqiti Panelit dosjen e AKM-së lidhur me privatizimin e IMN-së, duke i vënë në dispozicion vetëm dokumentet në posedim të tyre. Paneli mori dosjen e Dhomës së Posaçme për rastin. Prandaj, Paneli do të vlerësojë bazueshmërinë e ankesës në bazë të dokumenteve që atij i janë vënë në dispozicion.

b) Ligjet e aplikueshme vendore

49. Në fillim, Paneli thekson se kërkesa e ankuesit për t'u përfshirë në listën e të punësuarve të kualifikuar që të marrin një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të "IMN-së" ishte shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme në dritë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45 të 19 nëntorit të vitit 2004, e cila përcakton procedurat ligjore për kundërshtimin e listës së punëtorëve të lëshuar nga AKM-ja.

50. Neni 10.1 i Rregullores njeh "statusin special" të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore dhe ndikimin që privatizimi e ka në statusin e tyre. Sipas kësaj dispozite, 20% e të ardhurave nga shitja e aksioneve të ndërmarrjes shoqërore të privatizuar janë të rezervuara për punëtorët e ndërmarrjes, të cilët i plotësojnë kushtet e caktuara. Një punëtor konsiderohet i kualifikuar për të marrë një pjesë, nëse ai/ajo është regjistruar si punëtor në ndërmarrje shoqërore në kohën e privatizimit dhe është vërtetuar se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tre vjet (neni 10.4).

51. Neni 10.2 dhe 10.3 i Rregullores nr. 2003/13 përcakton procedurën që duhet ndjekur nga AKM-ja kur krijohet lista e punëtorëve të kualifikuar. Duke marrë parasysh kontekstin e veçantë në të cilin ndodhi privatizimi në Kosovë, neni 10.2 i Rregullores siguron që, fillimisht, lista e punëtorëve do të formulohet në bazë mosdiskriminimi nga një organ përfaqësues i punëtorëve në ndërmarrjen përkatëse, në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe pastaj i bartet AKM-së. Bordi i AKM-së shqyrton listën dhe bën rregullimet që është e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë të të gjithë punëtorëve të kualifikuar në paratë që do të shpërndahen. Lista zyrtare pastaj bëhet

publike nga AKM-ja, së bashku me një njoftim që informon se çdo palë e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër listës (neni 10.3).

52. Ndërsa përcaktohen kriteret të cilat punëtori duhet t'i plotësojë me qëllim që të jetë i kualifikuar për t'u përfshirë në listë, neni 10.4 i Rregullores thotë se dështimi për të plotësuar kriteret e tilla nuk është pengesë për t'u përfshirë në listë, sapo të mund të dëshmohet se punëtori do të kishte qenë i kualifikuar për përfshirje nëse ai/ajo nuk do të kishte qenë i diskriminuar. Punëtorët e tillë mund të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme në pajtim me nenin 10.6.

53. Neni 10.6 (b) i Rregullores ka të bëjë me dëshminë që duhet paraqitur Dhomës së Posaçme ish-punëtorët që kërkojnë të përfshihen në listë: "Çdo ankesë që i paraqitet Dhomës së Posaçme mbi baza të diskriminimit, si arsye për përjashtim nga lista e punëtorëve të kualifikuar, duhet të ketë të bashkëngjitura dëshmi dokumentuese për diskriminimin e pretenduar."

54. Në vendimin e vet të 15 qershorit të vitit 2006, Dhoma e Posaçme konsideron se neni 10.6 (b) i Rregullores 2003/13 është zëvendësuar me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit (Ligji nr. 2004/3), i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 dhe i shpallur nga PSSP-ja më 20 gusht 2004 (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32 mbi shpalljen e Ligjit Kundër Diskriminimit, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës).

55. Ligji kundër Diskriminimit është miratuar me qëllim të parandalimit të diskriminimit dhe të promovimit dhe futjes në përdorim të parimit për trajtim të barabartë të qytetarëve të Kosovës. Dispozitat e tij relevante thonë si në vijim:

Neni 8

Pesha e dëshmisë

"8.1. Kur personat të cilët konsiderojnë se atyre u është bërë padrejtësi, sepse parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar, paraqesin para një gjykate apo autoriteti tjetër kompetent faktet, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, i takon palës së paditur të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk parandalon futjen në përdorim të rregullave për dëshmi të cilat janë më të favorshme për paditësit. Veç kësaj, një ankues mund të ngre apo mbrojë rastin e tij të diskriminimit me çdo mjet, duke përfshirë bazën e dëshmive statistikore."

Neni 11

"11.1. Kur ky ligj hyn në fuqi, ai i zëvendëson të gjitha ligjet e mëparshme të aplikueshme nga kjo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit të paraqitur apo në fuqi për mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë janë akoma valide dhe duhet të zbatohen nëse ato janë më të favorshme sesa dispozitat e këtij Ligji."

c) Mbi aplikueshmërinë e nenit 14 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

56. Ankuesi pretendon se procedurat para Dhomës së Posaçme kanë shkelur nenin 14, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në pjesët relevante të këtyre dispozitave thuhet:

Neni 14

"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në [K] konventë duhet të sigurohet pa diskriminim në çfarëdo baze si p.sh.…origjinës nacionale apo sociale, lidhja me një minoritet nacional … apo status tjetër."

Neni 6

"Në përcaktimin e të drejtave dhe lirive të tij civile … secili ka të drejtë për gjykim … të drejtë … nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i krijuar me ligj."

57. Në fillim, Paneli hedh poshtë vërejtjet e PSSP-së se neni 14 nuk vlen për rastin aktual bazuar në argumentet që: neni 14, sipas pikëpamjes së tij, vlen vetëm në rastin kur është gjetur një shkelje e dispozitës esenciale të Konventës (në këtë rast të nenit 6); se neni 14 nuk vlen për rastet e ndërlidhura me punësim.

58. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se në fillim të vitit 1968, *në rastin e Linguistikës Belge*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vazhdimisht ka theksuar se ndërsa është e vërtetë se garancia për mosdiskriminim sipas nenit 14 nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi ajo ka të bëjë vetëm me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, akoma mund të ketë shkelje të nenit 14 madje edhe kur e drejta esenciale që përmendet nuk është shkelur, me kusht që faktet për çështjen bien brenda kufirit të një apo më shumë dispozitave të Konventës (shih GJEDNJ, *Rasti "Në lidhje me aspekte të caktuara të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve në Belgjikë"kundër Belgjikës*, nr. 1474/62 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës i 23 korrikut të vitit 1968, § 9; shih gjithashtu GJEDNJ, *Van Raalte kundër Holandës*, nr. 20060/92, vendimi i gjykatës, 21 shkurt 1997, § 33; GJEDNJ, *Petroviq kundër Austrisë*, nr. 156/1996/775/976, vendimi i gjykatës i marsit të vitit 1998, § 22; GJEDNJ, Dhoma e Lartë [DHL], *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 65731/01 dhe 65900/01, vendimi i gjykatës, 12 prill 2006, § 51; GJEDNJ, *Zarb Adami kundër Maltës*, nr. 17209/02,vendimi i gjykatës, 20 qershor 2006, § 42; GJEDNJ [DHL], *Konstantin Markin kundër Rusisë*, nr. 30078/06, vendimi i gjykatës, 22 mars 2012, § 124; GJEDNJ [DHL], *Fabris kundër Francës*, nr. 16574/08, vendimi i gjykatës, 7 shkurt 2013, § 47).

59. Veç kësaj, Gjykata Evropiane ka konfirmuar aplikueshmërinë e nenit 14 në rastet e punësimit (shih, për shembull, GJEDNJ, *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, vendimi i gjykatës, 27 korrik 2004), duke përfshirë rastet e diskriminimit indirekt, ku nuk ka asnjë kërkesë për të provuar qëllimin diskriminues (shih GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 57325/00, vendimi i gjykatës, 13 nëntor 2007, § 194; dhe GJEDNJ, *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11,vendimi i gjykatës, 29 janar 2013§ 106).

60. Paneli thekson se në rastin aktual ankuesi pohon se ai ishte diskriminuar gjatë procedurave të privatizimit para AKM-së dhe Dhomës së Posaçme. Procedurat e tilla përbëjnë një përcaktim të të drejtave dhe obligimeve civile të ankuesit dhe kështu sjellin lëndën e ankuesit brenda fushës së nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas mendimit të Panelit, kjo është e mjaftueshme për ta bërë të aplikueshëm nenin 14.

d) Bazueshmëria e ankesës

Parimet e përgjithshme

61. Në përgjigje të pretendimeve të ankuesit në lidhje me diskriminim në bazë të origjinës etnike, Paneli do ta shqyrtojë pajtueshmërinë e procedurave të Dhomës së Posaçme me nenin 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 6.

62. Në fillim, Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për nenin 6 në të cilin thuhet se, përgjithësisht, "është detyrë e saj që të sigurojë zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga palët kontraktuese në Konventë. Në veçanti, nuk është funksioni i saj të merret me gabimet në fakte apo në ligj, që supozohet se bëhen nga gjykatat nacionale, veç nëse apo për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë" (shih GJEDNJ, *Garcia-Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, vendimi i gjykatës i 21 janarit të vitit 1999, § 28). Paneli thekson se në këtë rast pretendimi është se vendimi i Dhomës së Posaçme e ka shkelur të drejtën e ankuesit që të mos diskriminohet duke u bazuar në origjinën e tij etnike.

63. Mbi nenin 14 të KEDNJ-së, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane se diskriminimi nënkupton trajtimin ndryshe, pa ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, i personave në situatat e ngjashme (shih GJEDNJ, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, vendimi i gjykatës i 11 qershorit të vitit 2002, § 48, dhe *Okpisz kundër Gjermanisë*, nr. 59140/00, vendimi i gjykatës i 25 tetorit të vitit 2005, § 33). Megjithatë, Gjykata gjithashtu ka deklaruar se neni 14 nuk e ndalon një vend anëtar nga trajtimi ndryshe i grupeve me qëllim të korrigjimit të "pabarazive faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë në rrethana të caktuara një dështim për bërë përpjekje për të korrigjuar pabarazinë përmes trajtimit ndryshe mundet vetvetiu të sjellë deri te shkelja e nenit (shih GJEDNJ [DHL], *Thlimmenos kundër Greqisë*, nr. 34369/97, § 44, KEDNJ 2000-IV).

64. Gjykata ka sqaruar më tutje konceptin e diskriminimit indirekt "se një politikë apo masë e përgjithshme që ka efekt disproporcionalisht të dëmshëm në një grup të veçantë mund të konsiderohet diskriminuese, pavarësisht nga fakti se nuk ka për qëllim në mënyrë specifike atë grup dhe se "diskriminimi potencialisht në kundërshtim me Konventën mund të rezultojë nga një situatë *de facto*"" (shih, GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, përmendur në § 59 më lart, § 175 dhe rastet e përmendura aty).

65. Në mënyrë specifike mbi diskriminimin në bazë të origjinës etnike të personit, gjykata ka deklaruar se kjo është një formë e diskriminimit racor, e cila është "një mënyrë veçanërisht e padrejtë e diskriminimit dhe, duke pasur parasysh pasojat e saj të rrezikshme, kërkon nga autoritetet vigjilencë të veçantë dhe një reagim energjik" dhe "se asnjë dallim në trajtim që bazohet ekskluzivisht apo në shkallë vendimtare në origjinën etnike të personit nuk ka mundësi të justifikohet objektivisht në shoqërinë demokratike dhe moderne të ndërtuar mbi parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme" (shih GJEDNJ, *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, përmendur në § 59 më lart, § 101).

66. Sa i përket peshës së dëshmisë në rastet ku pretendohet diskriminimi, gjykata ka vendosur që "sapo pala ka treguar dallim në trajtim, i takon qeverisë të tregojë se ka qenë e justifikueshme" (shih GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, përmendur më lart, §§ 176-177; shih gjithashtu GJEDNJ [DHL], *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, vendimi i gjykatës, 16 mars 2010,§ 150).

Diskriminimi i pretenduar

67. Në rastin aktual, ankuesi pohon se e drejta e tij për të qenë i lirë nga diskriminimi është shkelur, sepse në rastet e tjera Dhoma e Posaçme vendosi në favor të pretenduesve, serbëve dhe minoriteteve të tjera, të cilët, sikur ankuesi, i kishin pasur marrëdhëniet e punës të ndërprera në vitin 1999-2000, për shkak të situatës së sigurisë. Ankuesi deklaron se në ato raste, Dhoma e Posaçme pranoi pretendimet e tyre për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar dhe se kjo është vendosur madje edhe kur ata (ndryshe nga ai) nuk kishin inicuar ndonjë procedurë gjyqësore. Ankuesi gjithashtu deklaron qartë se Dhoma e Posaçme nuk i ka qartësuar arsyet pse ankesa e tij është gjykuar ndryshe. Ai pohon se është diskriminuar për shkak të etnisë së tij egjiptiane.

68. Për sa i përket pohimit të ankuesit se ai i kishte paraqitur faktet para Dhomës së Posaçme për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit, Paneli së pari thekson se lënda e ankesës së ankuesit para Dhomës së Posaçme ishte se ai nuk kishte të drejtën për një pjesë të të ardhurave të privatizimit të IMN-së, në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ur nr. 2003/13: si një ish-punëtor, ai nuk mund të regjistrohej në ndërmarrje kur procesi i privatizimit filloi, sepse marrëdhënia e tij punës ishte ndërprerë në një mënyrë diskriminuese më 1999-2000. Paneli thekson se, në përkrahje të pretendimit të tij, ankuesi i paraqiti fakte dhe dëshmi dokumentuese AKM-së dhe Dhomës së Posaçme se, ai kishte punuar në IMN përafërsisht 20 vjet deri në mars-qershor 1999; se kur armiqësitë shpërthyen në Kosovë në vitin 1999, duke iu frikësuar persekutimit për shkak të etnisë së tij egjiptiane, ai iku si refugjat për në Mal të Zi dhe kështu nuk kishte mundësi më tutje të punojë për ndërmarrjen; se për këtë arsye i ishte ndërprerë marrëdhënia e tij e punës në IMN; dhe se pas një kohe të caktuar, ai kishte provuar ta rifillojë punën në IMN, pa sukses. Paneli gjithashtu thekson se gjatë procedurave të privatizimit, ankuesi gjithashtu e kishte informuar AKM-në se ai e kishte kundërshtuar në gjykatë ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës dhe se ai i kishte dërguar vendimet e miratuara nga Gjykata deri atëherë në lidhje me këtë. Paneli thekson më tutje se dosja e plotë e ankuesit ishte vënë në dispozicion nga AKM-ja për t'u shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme.

69. Në vendimin e vet SCEL-08-001, Dhoma e Posaçme hodhi poshtë ankesën a ankuesit, duke thënë se në përgjithësi ai kishte "dështuar të paraqesë fakte nga të cilat mund të provohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt". Paneli thekson se pavarësisht nga pesha e parashtresave të ankuesit, vendimi i Dhomës së Posaçme nuk i specifikoi arsyet se, pse faktet e paraqitura nga ankuesit ishin konsideruar të pamjaftueshme për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit apo si ishte vlerësuar dëshmia e paraqitur nga ankuesi. Në vendim më tutje thuhet shkurtimisht se Dhoma e Posaçme u pajtua me "analizën e AKM-së" se marrëdhënia e punës ankuesit i ishte ndërprerë "me vendimin nr. 185/00, i datës 24.08.2000" dhe se "ai nuk inicoi asnjë procedurë ligjore kundër këtij vendimi për t'u rikthyer në pozitën e mëparshme për të punuar"; megjithatë, ajo nuk qartëson se si kjo informatë për procedurat gjyqësore ku kundërshtohet ndërprerja e marrëdhënies së punës së ankuesit ishte konsideruar relevante në kontekst të ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesi.

70. Sa i përket pretendimit të ankuesit se ai ishe diskriminuar, kur merret parasysh praktika gjyqësore e Dhomës së Posaçme që pranon përfshirjen e punëtorëve serbë në listën e të punësuarve të kualifikuar në situatat e ngjashme me situatën e tij, ankuesi nuk i ofron Panelit shembuj konkretë në përkrahje të pretendimit të tij se Dhoma e Posaçme miratoi vendime që janë në kundërshtim me rastet e tjera të privatizimit. Megjithatë, Paneli e vëren qëndrimin e ndryshëm të miratuar nga Dhoma e Posaçme në rastet e tjera të privatizimit, nga qershori i vitit 2004 e më tutje, për sa i përket pretendimit të ish-punëtorëve se ata do të ishin të kualifikuar për t'u përfshirë nëse ata nuk do të ishin diskriminuar. Paneli thekson, për shembull, vendimin e Dhomës së Posaçme për privatizimin e "*Termosistemit*" të datës 9 qershor 2004, në të cilin një grupi prej 25 ish-

punëtorësh serbë, emrat e të cilëve ishin hequr nga regjistri i punëtorëve për shkak të dështimit që të paraqiten në detyrë në fillim të vitit 2000, iu pohua megjithatë e drejta e tyre për një pjesë të të ardhurave të privatizimit. Në atë rast, Dhoma e Posaçme, pasi i kishte marrë parasysh pretendimet e ankuesve se situata e sigurisë i kishte ndaluar ata që të jenë të pranishëm në punë "nga fillimi i vitit 2000 e më tutje" dhe se ata ishin hequr nga regjistri në një "mënyrë arbitrare dhe diskriminuese", konsideroi se ajo ishte "çështje e njohurisë së përgjithshme", si e tillë që nuk kërkon dëshmi tjetër, se pas bombardimit të NATO-s në vitin 1999 serbët dhe pjesëtarët e minoriteteve të tjera etnike ishin të detyruar t'i braktisin shtëpitë dhe vendet e tyre të punës për shkak të frikës nga reprezaljet. Dhoma e Posaçme konsideron më tutje se në një situatë të tillë, dështimi i ankuesve që të jenë të pranishëm në punë "nga fillimi i vitit 2000 e më tutje, nuk i atribuohet në asnjë mënyrë dëshirës së tyre që të mungojnë nga puna vullnetarisht, por kjo ishte për shkak të shqetësimeve mbi sigurinë, në të cilën situatë ata e gjetën veten" dhe se nuk ishte e pritshme që ata të "veprojnë në pajtim me informatën paralajmëruese të ndërmarrjes, ku ata informoheshin se mungesa e tyre nga puna prej më shumë se pesë ditësh do të rezultojë me largimin e tyre nga regjistri i punëtorëve". Prandaj, Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë parashtresën e të paditurit se pretenduesit ishin larguar nga puna si rezultat i procedurave disiplinore dhe gjeti në vend të kësaj se largimi i tyre kishte qenë "i parregullt" "dhe ishte bërë në një mënyrë që ishte në esencë jo e drejtë dhe diskriminuese". Dhoma e Posaçme përfundimisht njohu të drejtën e atyre punëtorëve në një pjesë nga të ardhurat.

71. Ngjashëm, në vendimin e vet SCEL-05-0002, të datës 17 janar 2006, në lidhje me privatizimin e Ndërmarrjes *"Progres"*, Dhoma e Posaçme konsideron se ata punëtorë që jetonin në veri të lumit Ibër, të cilët për arsye të sigurisë nuk mund të kalonin në anën tjetër të lumit ku ishte e vendosur ndërmarrja, kishin qenë "të diskriminuar për sa i përket mundësisë së tyre për ta vazhduar marrëdhënien e tyre të punës" në ndërmarrje. Në mesin e shumë vendimeve të tjera, vendimi i Dhomës së Posaçme SCEL-09-0012, i shpallur më 8 shtator 2010, tregon se qasja e njëjtë gjithashtu ishte miratuar nga Dhoma e Posaçme pas vendimit të vet për rastin e ankuesit.

72. Duke u pajtuar me ankuesin se refuzimi i kërkesës së tij për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar ishte në kundërshtim me praktikën gjyqësore konsekuente të Dhomës së Posaçme në rastet analoge, Paneli do të vlerësojë nëse kjo situatë arrin deri në shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 6. Në këtë drejtim, Paneli rikujton jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se, si parim i përgjithshëm, "kërkesa për siguri gjyqësore dhe mbrojtje të pritjeve legjitime nuk përfshin të drejtën për një jurisprudencë të ngritur" (shih GJEDNJ, *Unédic kundër Francës*, nr. 20153/04, vendimi i gjykatës, 18 dhjetor 2008, § 74; dhe GJEDNJ, *Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 36815/03, vendimi i gjykatës, 14 janar 2010, §38).

73. Gjykata gjithashtu ka konsideruar se ekzistenca e divergjencave madje brenda gjykatës së njëjtë nuk mundet vetvetiu të konsiderohet në kundërshtim me Konventën (shih, GJEDNJ, *Santos Pinto kundër Portugalisë*, nr. 39005/04, vendimi i gjykatës, 20 maj 2008, § 41); sidoqoftë, mund të ketë raste ku divergjencat në praktikën gjyqësore çojnë kah gjetja e një shkelje të nenit 6. Në veçanti, gjykata ka theksuar se kur, si në këtë rast, vendimet divergjente shpallen nga një gjykatë e veçantë supreme vendore, apo nga gjykatat e ndryshme në degën e njëjtë të sistemit ligjor që vendosin në instancën e fundit, zgjatja e gjykimeve konfliktuoze mund të krijojë një shtet me pasiguri ligjore që ka të ngjarë të ulë besimin publik në sistemin e drejtësisë (shih GJEDNJ, *Beian kundër Rumanisë (nr. 1)*, nr. 30658/05, vendimi i gjykatës, 6 dhjetor 2007, §§38-39). Me qëllim të përcaktimit nëse një pasiguri e tillë ekziston rast pas rasti, Gjykata e ka marrë në konsideratë nëse ekzistojnë

"dallime të thella dhe të vjetra" në praktikën gjyqësore të gjykatës supreme, nëse ligji vendor siguron mekanizmin për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, nëse mekanizmi është përdorur dhe, nëse është e nevojshme, deri në çfarë niveli" (shih, GJEDNJ [DHL], *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05, vendimi i gjykatës, 20 tetor 2011, § 53). Përveç kësaj, Gjykata e ka marrë parasysh nëse mospërputhja është një rast i izoluar apo prek numër të madh të njerëzve (shih GJEDNJ, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 34796/09 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 10 maj 2012; dhe GJEDNJ, *Tudor Tudor kundër Bullgarisë*, nr. 21911/03, vendimi i gjykatës 24 mars 2009. Veç kësaj, për sa i përket mospërputhjeve në lidhje me jurisprudencën në kuadër të gjykatës supreme, Gjykata Evropiane ka deklaruar se është detyrë e gjykatave që vendosin në instancën e fundit që të ofrojnë arsyetim më substancial kur vendoset në kundërshtim me praktikën e themeluar gjyqësore (shih GJEDNJ, *Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, përmendur më lart, § 38).

74. Duke iu kthyer rrethanave të rastit aktual, Paneli thekson se Dhoma e Posaçme është themeluar në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës, si organi i vetëm i mandatuar të vendosë mbi ankesat e punëtorëve në shkallën e parë dhe të dytë, pasi nuk ishte i mundshëm asnjë apelim nga vendimet e saj, së paku deri në fund të vitit 2008 (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Todoroviq*, nr. 33/08, vendimi i gjyqit, 17 prill 2009, §§ 34-36). Paneli gjithashtu thekson se divergjencat në praktikën gjyqësore të Dhomës së Posaçme ishin të thella dhe të vjetra siç është përshkruar më lart, ndërsa nuk është paraparë asnjë mekanizëm apo procedurë në kornizën ligjore me qëllim të tejkalimit të divergjencave të tilla. Këto divergjenca ishin të tilla pasi preknin potencialisht një numër të madh të njerëzve në kontekst të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë dhe së këndejmi rrezikojnë parimin e sigurisë ligjore për sa i përket këtij procesi. Paneli konsideron se kjo mungesë e sigurisë për sa i përket praktikës gjyqësore, kishte ndikim në privimin e ankuesit nga mundësia e marrjes së një pjese nga të ardhurat e privatizimit të IMN-së, ndërsa personave tjerë në situatë të ngjashme u ishte dhënë kjo e drejtë (krahaso me GJEDNJ, *Beian kundër Rumanisë (nr. 1)*, përmendur më lart, § 40). Paneli thekson më tutje se Dhoma e Posaçme nuk ofroi një sqarim të kënaqshëm se pse për këtë rast ishte vendosur ndryshe nga rastet e pjesëtarëve tjerë të pakicave nacionale në situatën e njëjtë faktike.

75. Për sa i përket pohimit të ankuesit se ai ishte diskriminuar kundrejt *vis-à-vis* ish-kolegëve të tij serbë në IMN, Paneli thekson se kjo parashtresë iu ka paraqitur vetëm Panelit dhe jo Dhomës së Posaçme, e cila prandaj nuk e ka marrë atë në shqyrtim. Veç kësaj, për shkak të mungesës së qasjes në dokumentet relevante të AKM-së, Paneli nuk ishte në gjendje të verifikojë nëse në kuadër të procesit të privatizimit të IMN-së, ish-punëtorët në situatë të njëjtë me të ankuesit ishin trajtuar më favorshëm sesa ai, siç pohohet nga ankuesi.

76. Paneli thekson se një çështje e veçantë sipas nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ngritët nga pohimi i ankuesit se, në rastin e tij specifik, Dhoma e Posaçme plotësisht e injoroi ekzistimin e diskriminimit indirekt ndaj tij si pjesëtar i minoritetit egjiptian. Siç është theksuar nga Dhoma e Posaçme në rastet e përmendura më lart, kjo ishte "çështje e njohurisë së përgjithshme" dhe si e tillë nuk kërkon dëshmi të mëtejme (shih § 70 më lart). Ankuesi gjithashtu argumenton se ai ishte i detyruar të largohet nga Kosova dhe e kishte të pamundur të kthehet në ndërmarrje dhe të vazhdojë me kryerjen e aktiviteteve të punës, për shkak të përkatësisë së tij etnike. Nëse situata e sigurisë do t'u lejonte personave të komuniteteve etnike minoritare të qëndrojnë në territor, ai do të kishte mbetur në listën e pagave të ndërmarrjes dhe kështu do të kishte plotësisht të drejtë në një pjesë nga të ardhurat që rrjedhin nga privatizimi i saj. Si rezultat i pamundësisë së tij që të kthehet në punë, ai u eliminua nga procesi i privatizimit. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, kërkimi i detaleve të tjera që tregojnë diskriminimin, bazuar në rrethanat

konkrete, do të vendoste peshë të pajustifikueshme në një numër të madh të komuniteteve minoritare.

77. Siç është treguar më lart, PSSP-ja thotë se në proceduat para Dhomës së Posaçme, ankuesi dështoi të ofrojë dëshmi relevante se ai ishte diskriminuar. Prandaj, PSSP-ja përfundon se Dhoma e Posaçme mori një vendim duke u bazuar në shqyrtim të duhur të dëshmisë para saj dhe se dështimi i ankuesit që të ofrojë dëshmi relevante në posedim të tij nuk mund të rezultojë me shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, shpallur në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së apo neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Duke u bazuar në këtë që u cek më lart, UNMIK-u argumenton se kjo pjesë e ankesës është gjithashtu qartë e pabazuar.

78. Paneli konsideron se ankuesi, në esencë, ankohet për dështimin e Dhomës së Posaçme që të korrigjojë një pabarazi ekzistuese, viktima të së cilës ishin ankuesi dhe punëtorët e tjerë në situatë të njëjtë.

79. Përderisa i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane përkitazi me nenin 14, Paneli tanimë konsideron se "një rregull përgjithësisht e aplikueshme, megjithëse me sa duket e papërcaktuar, mund të ketë efekt në trajtimin e njerëzve ndryshe, p.sh. duke u bazuar në prejardhjen e tyre etnike. Ku një grup i personave, për shkak të origjinës së vet etnike, është në një pozitë të cenueshme krahasuar me personat e origjinës tjetër, autoritetet kompetente janë të obliguara t'u kushtojnë konsideratë të veçantë nevojave specifike të atij grupi të veçantë. Kjo konsideratë e veçantë kërkohet në të dyja në kornizën relevante rregulluese dhe në vendimet në rastet e veçanta" (shih, për sa i përket situatës së romëve në një numër shtetesh të Evropës Qendrore dhe Lindore, GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, përmendur në § 59 më lart, § 181; GJEDNJ [DHL], *Oršuš kundër Kroacisë*, përmendur në § 64 më lart, § 148; shih gjithashtu PKDNJ, *Parliq*, nr. 01/07, mendimi i 18 qershorit 2010, § 57).

80. Paneli thekson situatën e cenueshmërisë në të cilën personat e zhvendosur e gjetën veten në Kosovë si pasojë e konfliktit, dhe në veçanti cenueshmërinë e mëtutjeshme të këtyre individëve, sikur ankuesi, duke u takuar minoriteteve joserbe. Në pajtim me qëndrimin e shprehur më herët të Panelit në rastin *Parliq*, situata e tyre kërkoi miratimin e masave pozitive mbrojtëse nga autoritetet për t'u kushtuar rëndësi të veçantë të drejtave të tyre fundamentale, duke përfshirë të drejtat në kuadër të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë (shih PKDNJ, *Parliq*, përmendur më lart, § 55).

81. Paneli thekson se në nivel të kornizës ligjore, neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, e plotësuar me dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit mbi peshën e dëshmisë, siguroi mbrojtje adekuate megjithëse gjithashtu siguroi të drejtën e ish-punëtorëve, të cilët kanë qenë viktimë e diskriminimit direkt apo indirekt për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit. Megjithatë, Paneli konsideron se Dhoma e Posaçme i zbatoi ato dispozita në rastin aktual, pa marrë në konsideratë situatën e veçantë të ankuesit si pjesëtar i një minoriteti etnik, persekutimi i të cilit si pasojë e konfliktit ishte çështje e njohurisë së përgjithshme.

Pesha e dëshmisë

82. Paneli thekson me vlerësim se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës u miratuan jo vetëm që të parandalojnë diskriminimin por, gjithashtu, për të siguruar se procedurat gjyqësore do t'i bënin efektive garancitë ligjore për mosdiskriminim. Prandaj, neni 8.1 i Ligjit thotë se kur personat, që pretendojnë diskriminimin, ofrojnë fakte nga të cilat mund të provohet diskriminimi, i takon palës së paditur që t'i rrëzojë provat për diskriminim.

83. Paneli thekson se, në përkrahje të pretendimeve të tij, ankuesi i dorëzoi fakte dhe gjithashtu dëshmi dokumentare AKM-së dhe Dhomës së Posaçme se ai kishte punuar në IMN përafërsisht 20 vjet, deri në mars-qershor të vitit 1999; se kur shpërthyen armiqësitë në Kosovë në vitin 1999, duke iu frikësuar persekutimit për shkak të etnisë së tij, ai u largua si refugjat në Mal të Zi dhe kështu nuk mundi të punojë më gjatë për ndërmarrje; se për këtë arsye marrëdhënia e tij e punës në IMN i ishte ndërprerë; se pas një kohe të caktuar, ai kishte bërë përpjekje të rifillojë punën në IMN, pa sukses.

84. Në dritë të këtyre parashtresave, Paneli konsideron se ankuesi kishte ofruar fakte të mjaftueshme për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit indirekt para Dhomës së Posaçme i cili, sipas ligjit, krijoi obligimin për AKM-në, si palë e paditur, që të dëshmojë se ankuesi, në fakt, nuk kishte qenë viktimë e trajtimit diskriminues. Megjithatë, Dhoma e Posaçme dështoi ta bëjë efektive këtë dispozitë; ajo pohoi se asnjë fakt i tillë nuk ishte paraqitur dhe kështu nuk iu kërkua AKM-së t'i hedhë poshtë pretendimet e ankuesit për diskriminim. Dhe Dhoma e Posaçme as që ka dhënë ndonjë arsye në lidhje me këtë.

85. Në përmbledhje, Paneli konsideron se Dhoma e Posaçme veproi në një mënyrë diskriminuese përmes devijimit nga praktika e vet e mëparshme gjyqësore; përmes dështimit të vet për të marrë parasysh diskriminimin indirekt që ka përjetuar ankuesi; dhe dështimit të saj që të përmbysë peshën e dëshmisë, siç kërkohet me nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

86. Duke marrë parasysh krejt atë që u tha më lart, Paneli thekson se ankuesi i ka paraqitur atij fakte të mjaftueshme për të provuar se Dhoma e Posaçme e trajtoi atë ndryshe nga të tjerët në një situatë analoge. Paneli konsideron se kjo përbën një rast *prima facie* të diskriminimit, të cilin PSSP-ja nuk e ka kundërshtuar.

87. Prandaj, Paneli përfundon se ka pasur një shkelje të nenit 14, në lidhjet me nenin 6 të KEDNJ-së.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

88. Ankuesi gjithashtu ankohet se, si pasojë e faktit që procedurat para Dhomës së Posaçme nuk ishin të drejta dhe nuk u zhvilluan në një mënyrë jodiskriminuese, ai ishte privuar nga të drejtat materiale që rrjedhin nga procesi i privatizimit. Në këtë drejtim, ai thirret në shkelje të të drejtave të tij në pronë, të garantuara me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

89. Paneli, pa iu përgjigjur pyetjes nëse në këtë rast pretendimi i ankuesit për pjesën e të ardhurave të privatizimit të IMN-së përbën "pronësi" në kuadër të kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1, konsideron se kjo pjesë e ankesës deri në një shkallë të madhe përputhet me shqyrtimin e tij sipas nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 6 § 1.

90. Si pasojë, Paneli nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtohet ankesa gjithashtu nga pikëpamja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (krahasoje me PKDNJ, *Parliq*, përmendur në 79 më lart, §§ 47-49).

C. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së

91. Në vendimin e vet mbi pranueshmërinë, Paneli theksoi se ankuesi gjithashtu mund të ngritë çështje sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Paneli pranon rëndësinë e këtij Protokolli në adresimin e pabarazive, megjithatë, ai konsideron se asnjë çështje e

veçantë, përveç atyre të adresuara më lart, nuk del sipas kësaj dispozite dhe prandaj nuk është e nevojshme të shqyrtohet më tutje ankesa sipas kësaj dispozite.

V. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

92. Paneli rikujton që ai ka gjetur se ankuesi është diskriminuar në bazë të përkatësisë së tij etnike në procedurat para Dhomës së Posaçme.

93. Paneli gjithashtu rikujton se diskriminimi racor dhe diskriminimi në bazë të prejardhjes etnike përbëjnë një lloj veçanërisht të padrejtë të diskriminimit i cili, sipas pasojave të veta, kërkon nga autoritetet një "veprim të fuqishëm" kurdo që identifikohet një lloj i diskriminimit (shih § 65 më lart).

94. Paneli thekson se në rastin aktual, do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, Paneli tanimë ka theksuar në rastet e tjera të sjella para tij (shih, në mesin e shumë rasteve të tjera, PKDNJ, *S.C.*, nr. 02/09, mendimi i 6 dhjetorit 2012; dhe *Laliq*, nr. 31/08, mendimi i 14 marsit 2013) se, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ndaloi kryerjen e funksioneve ekzekutive në Kosovë, dhe ky fakt kufizoi aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera. Paneli gjithashtu ka theksuar se përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit.

95. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

Për sa i përket ankuesit dhe rastit Paneli konsideron se është e nevojshme që UNMIK-u:

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit, Paneli mendon se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* EULEX-it dhe autoriteteve të Kosovës të sigurojë që kërkesa e ankuesit për një pjesë të të ardhurave të privatizimit të IMN-së të bëhet lëndë për shqyrtim nga Dhoma e Posaçme, nëse ankuesi e dëshiron këtë (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, § 333, KEDNJ 2004-VII; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i gjykatës, 2 mars 2010, § 171, KEDNJ 2010 (pjesë të shkëputura); GJEDNJ (DHL), *Catan dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 43370/04 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 19 tetor 2012, § 109; shih gjithashtu PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, përmendur në § 34 më lart, në § 49).

- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të Dhomës së Posaçme të gjykojë për ankesën e ankuesit në një bazë jodiskriminuese, dhe t'i kërkojë falje publike ankuesit në lidhje me këtë;

- Të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesin, për dëmin e shkaktuar jopasuror si rezultat i diskriminimit të tij në procedurat para Dhomës së Posaçme.

Paneli gjithashtu e konsideron të nevojshme që UNMIK-u:

- Të ndërmarrë hapa të duhur tek autoritetet kompetente në Kosovë që të sigurojë implementim të plotë të Ligjit të Kosovës kundër Diskriminimit si një garanci për mospërsëritje.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 14 TË KEDNJ-së NË LIDHJE ME NENIN 6 TË KEDNJ-së;**

2. **NUK KONSTATON SE KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KEDNJ-së;**

3. **NUK KONSTATON SE KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 12 TË KEDNJ-së;**

4. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **T'U KËRKOJË EULEX-it DHE AUTORITETEVE TË TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË VEPROJNË NË DREJTIM TË RISHQYRTIMIT NGA ANA E DHOMËS SË POSAÇME TË ANKESËS SË ANKUESIT PËR NJË PJESË TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I IMN-së, NËSE ANKUESI E DËSHIRON KËTË;**

   b. **T'I KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESIT PËR SHKAK TË DËSHTIMIT TË DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKOJË ANKESËN E TIJ NË NJË BAZË JODISKRIMINUESE;**

   c. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR PËR PAGESËN E KOMPENSIMIT ADEKUAT PËR ANKUESIN, PËR DËMIN E SHKAKTUAR JOPASUROR SI REZULTAT I DISKRIMINIMIT;**

   d. **TË NDËRLIDHET ME AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË SIGUROJË IMPLEMENTIM TË PLOTË TË LIGJIT TË KOSOVËS KUNDËR DISKRIMINIMIT SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;**

   e. **TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues